

URDHËR
Nr. 1593/1, datë 31.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Mbrojtjes zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, për nënshkrimin e akteve administrative, nga data 3.8.2026 deri më datë 6.8.2026.
 2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi